

Në bazë të nenit 55 alineja 1 i Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 и 51/11) dhe në bazë të nenit 25 paragrafi 2 dhe paragrafi 5 i Ligjit për arsim fillor (, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. бр. 103/08, 33/2010, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12 и 24/13), si dhe në bazë të nenit 6 dhe 7 paragrafi 1, alineja 4 i Ligjit për Byronë për zhvillimin e arsimit (“ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”) nr. 37/06, 142/08, 148/09, 69/13, 120/13, 148/13), ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi Programin mësimorë për lëndën e SHOQËRIA për klasën e I të arsimit fillorë

PROGRAMI I SHKURTUAR MËSIMOR



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
Byroja e zhvillimit të arsimit

# SHOQËRIA

SHTATOR 2020

**KLASA I**

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

## 1. HYRJA

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore SHOQËRIA bazohet në qëllimet/rezultatet e pritura të parashikuara me programin e rregullt mësimor për këtë lëndë të paraparë me planin mësimorë.

Në Programin e shkurtuar mësimor janë përcaktuar temat dhe njësitë të cilat duhet të realizohen për 159 ditë mësimore duke pasur parasysh fondin javor të orëve mësimore që është përcaktuar në programin e rregullt mësimor 1 orë në javë me gjithsejt 32 orë mësimore.

Arsimtari gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga Programi i shkurtuar nisët nga qëllimet/rezultatet e pritura, nocionet e përcaktuara në program, metodat dhe aktivitetet e miratuara në programin e rregullt mësimor.

Programi i shkurtuar mësimor nga lënda mësimore SHOQËRIA për klasën e parë realizohet në vitin shkollor 2020/2021

## 2. Pasqyra e temave dhe njësive mësimore

TEMA: UNË DHE TË TJERËT (7 ORË)
---------------------------------

<b>NJËSITË MËSIMORE:</b>
--------------------------

- |  |
|--|
| <ol style="list-style-type: none"><li>1. Unë jam</li><li>2. Çfarë mundem</li><li>3. Në çfarë jam më i mirë</li><li>4. Ndjenjat e mia</li><li>5. Sjellje e kulturuar</li><li>6. Unë dhe të tjerët ngjshmëritë dhe dallimet</li><li>7. Shokët dhe shoqet</li></ol> |
|--|

**TEMA: SHKOLLA IME (8 ORË)**

**NJËSITË MËSIMORE:**

1. Dita ime e parë në shkollë
2. Shkolla ime
3. Unë jam nxënës, të drejtat dhe obligimet e mia
4. Klasa ime
5. Rregullat e sjelljes në klasë
6. Të punësuarit e shkollës
7. Hapësirat e shkollës
8. Festat e shkollës.

**TEMA: SHTËPIA IME ( 6 ORË)**

**NJËSITË MËSIMORE:**

1. Shtëpia ime
2. Familja ime
3. Rolet dhe rregullat e sjelljes në familje
4. Higjiena personale
5. Koha e lirë në familje
6. Festat familjare

**TEMA: VENDI KU JETOJ (5 ORË)**

**NJËSITË MËSIMORE:**

1. K u jetoj, qytet- fshat

2. Objektet në vendin ku jetoj
3. Kush çfarë punon, mjetet për punë
4. E kaluara dhe tashmja
5. Atdheu im, flamuri dhe himni

### TEMA: KOMUNIKACIONI (6 ORË)

#### NJËSITË MËSIMORE:

1. Rruga nga shtëpia në shkollë
2. Kalimi i sigurtë i rrugës
3. Vendet ku lejohet të luhet
4. Mjetet e komunikacionit
5. Shenjat e komunikacionit, semafori
6. Polici i komunikacionit

### 3. Rekomandimet didaktike

Pikënisja e realizimit të programit të shkurtuar nga lënda e **SHOQËRIA** është programi i rregullt mësimor i kësaj lënde. (qëllimet konkrete, nocionete, aktivitetete propozuara , metodat dhe mjetet mësimore)

Fëmija qysh nga mosha e hershme fëmijërore shfaq kuriozitet spontan dhe interes për botën për rreth tij. Ata kanë përfituar përvoja për rrethin e drejtëpërdrejtë ku ata jetojnë, për shtëpinë, shkollën, lagjen e tyre dhe rrethin më të afërt ku ata jetojnë etj,

Për shkak së situatës me Kovid – 19 në shtetin tonë dhe kudo në botë arsimtari do të ketë kujdes gjatë realizimit të njësive mësimore. Aktivitete nga kjo lëndë do të relizohen në klasë duke përdorur mjete vizuale të ndryshme fotografji, aplikacione, makete, libra të ilustruar , revista, TV emisionet dhe përmbajtje digjitale.

Gjatë realizimit të orëve mësimore nga lënda Shoqëria me prezencë fizike duhet që nxënësit të respektojnë protokolet për distancë fizike dhe mbrojtje personale..

Ora mësimore do të zgjasë 30 minuta. Arsimtari do të shkurtojë pjesën hyrëse dhe përfundimtare të orës mësimore, më së paku të zgjasë 5 minuta dhe përmes teknikave të motivimit të nxënësve për pjesëmarrje aktive gjatë procesit të të nxënësve dhe mësuarit.

Gjatë realizimit të orëve mësimore nga lënda Shoqëria posaçërisht i kushtohet rëndësi formimit të nocioneve nga ana e nxënësve dhe shumë mvarret nga zbatimi i qasjes së integruar dhe fleksibilitetit gjatë realizimit të këtij programi.

Realizimi i qëllimeve mësimore dhe arritja e rezultateve të pritura të arrihet përmes aktiviteteve të llojllojshme të të nxënësve dhe të mësuarit. Metodatat mësimore për nxënësve dhe mësuesit, duhet të përshtaten me kohëzgjatjen e orës mësimore, duke ruajtur cilësinë në mësime. Arsimtari duhet të krijojë situata për mësuesit ku do të vijë në shprehje aktivitetet e llojllojshme mësimore ku përdoren mjete, materiale dhe burime të - përmbajtjet, që nxënësve më lehtë të mbajnë mend gjërat e mësuara. Arsimtari i prezenton e përmbajtjet dhe më pas sqaron, bisedon pyet dhe jep udhëzime nxënësve, e qëllimi është, që të nxitet interesi për këtë lëndë. E-përmbajtjet duhet të jenë të përshtatshme për moshën e nxënësve.

Detyrat e pamvarura të shtëpisë, për nxënësve po ashtu duhet të jenë në përputhje me moshën zhvillimore të fëmijëve.

#### **4. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR**

Programin e shkurtuar mësimor e realizon arsimtari klasor në përputhshmeri me Normativin për kuadër mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor nga lënda SHOQËRIA për klasën e parë të arsimit fillor nëntëvjeçar e miratoi

MINISTËR I ARSIMIT DHE SHKENCËS

Mila Carovska